



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 17

Tiranë – E enjte, 4 shkurt 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 11/2021, datë 1.2.2021	Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit të Shqipëri (ISKK)..... 2263
Vendim i Kuvendit nr. 12/2021, datë 1.2.2021	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare..... 2266
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1045, datë 15.1.2020	Për mënyrën e ndërldhjes, nivelin e aksesit dhe të bashkëveprimit të sistemit elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë me bazat e tjera të të dhënave..... 2266
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 53, datë 27.1.2021	Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovenisë, për ngritjen e një ndërtese modulare për qëllime arsimore, një donacion i Republikës së Sllovenisë për Republikën e Shqipërisë pas tërmetit të nëntorit 2019..... 2268
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 44, datë 26.1.2021	Për miratimin e kontratës tip për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe subjektit fitues të procedurës së konkurrimit publik..... 2272
Vendim i Prokurorit të Përgjithshëm nr. 1681/15, datë 29.1.2021	Për rezultatin e zgjedhjeve dhe shpalljen e fituesve 2276
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 1263, datë 29.1.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit: “Rikualifikimi urban i bllokut nr. 1, lagja nr. 2” 2276
Kërkesë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 1148/2, datë 28.1.2021	Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të llojit “tokë truall”, që preken nga ndërtimi i objektit: “Itinerare këmbësorësh me pistë vrapimi dhe biçikletash në Parkun e Liqenit Artificial” 2278

**VENDIM**
Nr. 11/2021**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS,
ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË
POZICIONEVE TË PUNËS TË
INSTITUTIT TË STUDIMEVE TË
KRIMEVE DHE PASOJAVE TË
KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI (ISKK)**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**


- I. Struktura e ISKK-së është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur.
- II. Organika e ISKK-së është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 1.2.2021.



STRUKTURA E INSTITUTIT TË STUDIMEVE TË KRIMEVE DHE PASOJAVE TË KOMUNIZMIT





Lidhja nr.2

ORGANIKA E INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT

	Funksioni	Kategoria	Nr. i Punonjësve
I	DREJTORI EKZEKUTIV	I-b	1
II	DREJTORIA E ARKIVIT DHE BIBLIOTEKËS		5
	<i>Zv.drejt看 ekzekutiv dhe drejt看 i Arkivit</i>	II-a	1
	Specialist (katalogim, inventarizim dhe përpunim i dokumenteve)	III-b	1
	Specialist (katalogim, inventarizim dhe përpunim i dokumenteve)	III-b	1
	Specialist Biblioteke (katalogim, inventarizim i fondit të bibliotekës etj.)	III-b	1
	Specialist	IV-a	1
	DREJTORIA E STUDIMEVE		7
	<i>Drejt看 drejtorie</i>	II-b	1
	<u>Spektori i Kërkimit Shkencor</u>		3
	Përgjegjës sektori – Studiues (i ri)	III-a	1
	Specialist	III-b	1
	Specialist - redaktor (i ri)	IV-a	1
	<u>Spektori i Edukimit dhe Informimit Publik</u>		3
	Përgjegjës sektori – Studiues (i ri)	III-a	1
	Specialist i Projekteve Audiovizuale	III-b	1
III	Specialist i Marrëdhënieve me Publikun	III-b	1
IV	DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		6
	<i>Drejt看 drejtorie</i>	II-b	1
	Specialist i Financës dhe i Buxhetit (i ri)	III-b	1
	Specialist i Burimeve Njerëzore dhe sekretari/protokoll	III-b	1
	Specialist jurist dhe i shërbimeve me gjyqësorin	III-b	1
	Specialist IT (database ISKK/arkiva elektronike)	IV-a	1
	Shofer	Kl. IV	1
	PUNONJËS GJITHSEJ		19

**VENDIM
Nr. 12/2021****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 114, pika 3, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Zoti Lorenc Bako zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 1.2.2021.

**VENDIM
Nr. 1045, datë 15.1.2020****PËR MËNYRËN E NDËRLIDHJES,
NIVELIN E AKSESIT DHE TË
BASHKËVEPRIMIT TË SISTEMIT
ELEKTRONIK TË DHOMËS
KOMBËTARE TË NOTERISË ME
BAZAT E TJERA TË TË DHËNAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 96, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sistemi elektronik i Dhomës Kombëtare të Noterisë (në vijim, sistemi elektronik i Dhomës) ndërlidhet me Regjistrin Kombëtar të Zyrës së

Gjendjes Civile, me Regjistrin Publik të Pasurive të Paluajtshme, me Regjistrin e Barrëve Siguruese, me Regjistrin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, si dhe me sistemet informatike të agjencive shtetërore/publike ose private e të sistemit bankar, me qëllim tërheqjen e informacionit të nevojshëm për hartimin e aktit dhe veprimin noterial.

2. Sistemi elektronik i Dhomës merr nga Regjistri Kombëtar i Zyrës së Gjendjes Civile të dhënat e mëposhtme:

- a) emri;
- b) mbiemri;
- c) numri personal;
- ç) datëlindja;
- d) vendlindja;
- dh) gjinia;
- e) shtetësia;
- ë) raportet e atësisë dhe amësisë;
- f) gjendja civile;
- g) kombësia;
- gj) vdekja;
- h) shpallja i/e zhdukur;
- i) vendbanimi;
- j) vendqëndrimi;

k) dokumentet e nevojshme që vërtetojnë dhe dokumentojnë përbërësit e gjendjes civile, si më sipër.

3. Sistemi elektronik i Dhomës merr nga Regjistri Publik i Pasurive të Paluajtshme të dhënat e mëposhtme:

- a) kartelën e pasurisë, e cila përmban:
 - i. pozicionin gjeografik të pasurisë;
 - ii. sipërfaqen e pasurisë;
 - iii. llojin e pasurisë së paluajtshme (ndërtesë, truall, arë, kullotë etj.);
 - iv. identifikimin e pronarit të pasurisë;
 - v. numrin e pasurisë;
 - vi. vlerën e pasurisë;
 - vii. aktin nga i cili ka lindur titulli i pronësisë mbi pasurinë;
 - viii. të drejtat e të tretëve mbi pasurinë;
 - ix. çdo akt tjetër që ndryshon regjimin juridik të pronës apo krijon të drejta apo detyrime mbi pasurinë;
 - x. të dhëna të tjera që përmbahen në kartelën e pasurisë, që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- b) hartën kadastrale, e cila përmban:



i. kufijtë dhe pozicionin gjeografik të çdo pasurie;

ii. numrin unik identifikues të çdo pasurie brenda numrit të zonës kadastrale;

iii. të dhënat e tjera teknike, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

c) planin e rievimit;

ç) vërtetimin nga regjistrat e veçantë (hipotekorë ose të lejes së ndërtimit dhe të karabinasë).

4. Ndërveprimi i sistemit elektronik të Dhomës me Regjistrin Publik të Pasurive të Paluajtshme lidhur me kërkesat për marrjen e shërbimeve kadastrale bëhet në përputhje me ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, ligjin nr. 110/2018, “Për noterinë”, dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

5. Sistemi elektronik i Dhomës merr nga Regjistri i Barrëve Siguruese të dhënat aktive të ruajtura në regjistrë, të parashikuara në rregulloren për barrët siguruese dhe të nevojshme për transaksionin, që i korrespondojnë:

a) emrit të barrëdhënësit;

b) numrit të serisë së mallrave me numër serie;

c) numrit të regjistrimit.

6. Rezultati i kërkimit në Regjistrin e Barrëve Siguruese duhet të përmbajë të gjitha faktet e marra nga regjistri, përfshirë datën, ndryshimin, shuarjen ose nënrenditjen dhe radhën e regjistrimit.

7. Sistemi elektronik i Dhomës merr nga Regjistri i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor të dhënat e lejes së qarkullimit, që lidhen me të dhënat teknike të mjetit, duke përfshirë:

a) numrin e regjistrimit (targa);

b) numrin e identifikimit të mjetit (numri i shasisë);

c) llojin/tipin;

ç) markën;

d) emërtimin tregtar;

dh) ngjyrën;

e) numrin e serisë së lejes së qarkullimit dhe të certifikatës së pronësisë;

ë) dokumentacionin vërtetues të gjendjes së mjetit.

8. Ndërlidhja e sistemit elektronik të Dhomës me sistemet informatike të sistemit bankar, si dhe të agjencive të tjera shtetërore/publike ose private kryhet me marrëveshje ndërmjet Dhomës dhe institucionit administrues/subjekteve përgjegjëse të sistemit informatik përkatës.

9. Ndërlidhja dhe bashkëveprimi i sistemit elektronik të Dhomës me regjistrat elektronikë publikë, sipas pikave 2, 3, 5 dhe 7, të këtij vendimi, bëhet nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit, sipas specifikimeve teknike të ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore, e cila koordinohet, zhvillohet e administrohet nga Autoriteti Rregullator Koordinues i Bazave të të Dhënave Shtetërore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore, duke dhënë akses në të dhëna sipas parashikimeve në ligjin për noterinë dhe në këtë vendim.

10. Noterët kanë të drejtë leximi në të dhënat që përmbajnë regjistrat publikë, të cilët janë të nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë noteriale.

11. Ministria e Drejtësisë ka akses të plotë në informacionin që prodhohet, regjistrohet dhe administrohet në sistemin elektronik të Dhomës, në rolet:

a) lexues;

b) auditues;

c) monitorues;

ç) prodhues i statistikave përkatëse.

12. Aksesin, sipas pikës 11, të këtij vendimi, siguron që Ministria e Drejtësisë të kontrollojë, të verifikojë e të përpunojë të dhëna të sakta, në kohë reale, për të gjitha aktet dhe veprimet noteriale.

13. Sistemi elektronik i Dhomës dërgon për regjistrim, në kohë reale, në sistemin elektronik të regjistrat noterial shqiptar:

a) të dhënat për aktet noteriale;

b) të dhënat për veprimet noteriale;

c) dokumentet e nënshkruara elektronikisht nga noter;

ç) të dhënat e testamenteve;

d) të dhënat e dëshmimeve të trashëgimisë ligjore apo testamentare;

dh) dokumentet e skanuara të akteve dhe veprimeve noteriale;

e) të dhënat për palët, individë dhe subjekte;

ë) informacione të tjera plotësuese për procese të punës së noterëve;

f) çdo të dhënë tjetër që duhet të përmbahet në sistemin elektronik të regjistrat noterial shqiptar, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

14. Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe çdo noter duhet të garantojnë regjistrimin në sistemin elektronik të Regjistrat Noterial Shqiptar të



akteve e veprimeve noteriale që prodhohen dhe regjistrohen në sistemin elektronik të Dhomës, sipas pikës 13, të këtij vendimi.

15. Në çdo rast, qasja dhe paraqitja e kërkesave nëpërmjet sistemit elektronik të Dhomës në regjistrat elektronikë publikë bëhen në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi që rregullon organizimin dhe funksionimin e regjistrit elektronik publik përkatës.

16. Dhoma Kombëtare e Noterisë, jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, siguron ndërveprimin e Regjistrit Noterial Shqiptar me Sistemin Elektronik të Dhomës.

17. Efektet financiare që lidhen me krijimin e kushteve të nevojshme teknike dhe organizative për zbatimin e këtij vendimi mbulohen nga Dhoma Kombëtare e Noterisë.

18. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe noterët për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 53, datë 27.1.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
SLLOVENISË, PËR NGRITJEN E NJË
NDËRTESE MODULARE PËR
QËLLIME ARSIMORE, NJË DONACION
I REPUBLIKËS SË SLLOVENISË PËR
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË PAS
TËRMETIT TË NËNTORIT 2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovenisë, për ngritjen e një ndërtese modulare për qëllime arsimore, një donacion i Republikës së Sllovenisë për Republikën e Shqipërisë pas tërmetit të nëntorit 2019, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
SLLOVENISË, “MBI NGRITJEN E NJË
NDËRTESE MODULARE PËR QËLLIME
ARSIMORE, NJË DONACION I
REPUBLIKËS SË SLLOVENISË PËR
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË PAS
TËRMETIT TË NËNTORIT 2019”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Sllovenisë vijim të referuara si “Palët”,

Kanë rënë dakord mbi çështjet e mëposhtme:

Neni 1
Qëllimi i marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi është të rregullojë parimet bazë të zbatimit të Projektit “Ngritja e një ndërtese modulare për qëllime arsimore, një donacion i Republikës së Sllovenisë për Republikën e Shqipërisë pas tërmetit të nëntorit 2019”, në formën e një ndërtese modulare të siguruar nga Republika e Sllovenisë për Republikën e Shqipërisë, për qëllime arsimore (në vijim i referuar si “Projekti”), në bashkëpunim dhe brenda objektivave të kushteve teknike të përcaktuar nga Njësia Zbatuese dhe titullari i Projektit, si dhe legjislacionet kombëtare në fuqi të Palëve.

2. Kjo mbështetje financiare në shumën prej 300.000 eurosh, është pjesë e angazhimit slloven në Konferencën e Donatorëve, të datës 17 shkurt



2020, “Së bashku për Shqipërinë”. Kjo Marrëveshje përbën një donacion në natyrë, në formën e objektit të parafabrikuar në shumën bruto të 300.000 eurosh, duke përfshirë fonde deri më 35.100 euro për kostot e punëve përgatitore (të themeleve). Përbushja e detyrimeve të titullarit të Projektit, siç përcaktohet në nenin 3, është parakusht për zbatimin e Projektit në përputhje me këtë Marrëveshje.

3. Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, Qendra për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Zhvillimin (CMSR) do të veprojë si Njësia Zbatuese për palën slovene me anë të së cilës, Bashkia e Krujës, në cilësinë e titullarit të Projektit (në vijim i referuar si “titullari i Projektit”) do të bashkëpunojë me Njësinë Zbatuese.

Neni 2

Kuadri ligjor dhe objekti i Projektit

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është në përputhje me ligjet dhe rregulloret e të dyja Palëve.

2. Brenda objektit të Projektit, një ndërtesë modulare për qëllime arsimore do të sigurohet nga Republika e Sllovenisë për Republikën e Shqipërisë, për të përbushur nevojat e menjëhershme akomoduese për qëllime arsimore në (Bashkinë e Krujës, Njësia Administrative e Cudhit), e prekur nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, në Shqipëri. Shkolla modulare e parashikuar pritet të përbëhet nga 3 klasa, 1 dhomë për mësuesit dhe tualete, duke përjashtuar mobilimin.

Neni 3

Detyrimet e Palëve

1. Brenda objektit të këtij Projekti, titullari i Projektit në Republikën e Shqipërisë do të sigurojë një truall të përshtatshëm dhe zonë me sipërfaqe të mjaftueshme, në pronësi apo disponim të titullarit të Projektit, për ngritjen e një ndërtese modulare të një cilësie të duhur në një zonë të prekur nga tërmeti.

2. Brenda objektit të këtij Projekti, Këshilli i Ministrave i Republikës të Shqipërisë do të alokojë në buxhet të Bashkisë së Krujës (titullari i Projektit) fondet e nevojshme për të mbuluar shpenzimet e:

a) një truall të përshtatshëm për vendosjen e ndërtesës modulare;

b) hartimit të projektit për projektin, bazuar në hartimin e draftprojekteve të ofruara nga Njësia Zbatuese, duke përfshirë të gjithë elementët e tjerë eventuale - peizazhi me fushat e sportive dhe këndet e lojërave, gardhin, planifikimin e masave komunale...;

c) planifikimin hapësinor për të gjitha marrëveshjet brenda projektit me marrjen e të gjitha lejeve dhe pëlqimeve të zbatueshme;

d) përgatitjen e sheshit të ndërtimit;

e) mbikëqyrjen e sheshit të ndërtimit;

f) menaxherit të kantierit;

g) të gjithë dokumentacionit të nevojshëm të kërkuar për punimet e ndërtimit;

h) punimeve të peizazhit;

i) kostove të tjera në lidhje me Projektin që nuk është detyrim i shprehur i Njesisë Zbatuese.

3. Titullari i Projektit do lidhë një Marrëveshje me CMSR-në ku përcakton të drejtat dhe detyrimet ndërmjet këtyre palëve dhe në mënyrë aktive do të lehtësojë zbatimin e Projektit.

4. Titullari i Projektit duhet të pajisë/sigurojë dhe të financojë për sa vijon:

- truall të përshtatshëm për vendosjen e ndërtesës modulare;

- hartimin e projektit për projektin, bazuar në hartimin e drafteve të projekteve të ofruara nga Njësia Zbatuese, duke përfshirë të gjithë elementët e tjerë eventuale - peizazhi me fushën sportive dhe këndet e lojërave, gardhin, planifikimin e masave komunale;

- planifikimin hapësinor për të gjitha marrëveshjet brenda projektit, me marrjen e të gjitha lejeve dhe pëlqimeve të zbatueshme (ndërtimi, mjedisi, licencat e autorizimit etj.) dhe dokumentacionin e nevojshëm bazuar në projektimin e miratuar të projektit të siguruar nga Njësia Zbatuese;

- zgjedh kontraktuesin për të gjitha punët, duke përfshirë punën përgatitore dhe peizazhin;

- menaxherin e kantierit;

- mbikëqyrja e sheshit të ndërtimit;

- të gjithë infrastrukturën e nevojshme të shërbimeve publike/komunale (furnizimin me energji elektrike, furnizimin me ujë, sistemin e kanalizimit, lidhjet e telekomunikacionit etj.) në kantier (gjithashtu gjatë ndërtimit dhe vendosjes së ndërtesës modulare), në përputhje me kërkesat teknike të Njesisë Zbatuese dhe Operatorin e



Projektit, duke përfshirë lidhjet e nevojshme për të mundësuar funksionimin e duhur të Projektit;

- procedurat e importimit, duke përfshirë marrjen e autorizimit për përjashtimin e TVSH-së dhe çdo përjashtim tjetër të detyrimeve, të cilat zbatohen për këtë projekt;

- mbajtëse mbeturinash për hedhjen e ambalazhit dhe materialit të mbetur;

- siguria e sheshit të ndërtimit, sigurimin e kushteve themelore për punëtorët në vend, sigurimin e ruajtjes së përkohshme të pajisjeve;

- marrjen e të gjitha certifikatave të përshtatshmërisë së cilësisë së materialeve të instaluar dhe pajtueshmërisë me standardet në fuqi;

- lejen e funksionimit;

- siguron zbatimin e qetë të projektit brenda grupeve lokale të interesit;

- mirëmbajtjen e rregullt të objektit gjatë kohëzgjatjes së tij;

- si dhe çdo aktivitet tjetër në lidhje me Projektin që nuk është përfshirë në Njësine Zbatuese të Detyrimeve.

Gjithashtu, titullari i Projektit duhet të pajisë/sigurojë për sa vijon:

- të kontraktojë një kompani ndërtuese për përgatitjen e sheshit të ndërtimit, duke përfshirë performancën e të gjitha punëve përgatitore të nevojshme (punë shembjeje, heqje mbetjesh dhe asgjësimin e duhur të tyre. Punimet e themeleve në përputhje me hartimin e projektit sipas kërkesave teknike të Operatorit të Projektit), të cilat do të bashkëfinancohen nga Njësia Zbatuese deri në shumën prej 35,100 eurosh, të cituar më lart në nenin 1, të kësaj Marrëveshjeje.

Prokurimi, dorëzimi dhe ngritja e një ndërtese modulare për qëllime arsimore do të organizohet nga Njësia Zbatuese. Projekti dhe normat e zbatimit do të jenë në përputhje me standardet shqiptare të Bashkimit Evropian dhe të certifikuara nga Zona Ekonomike Evropiane (EC). Palët bien dakord që kostot e përballuara nga Njësia Zbatuese do të kufizohen në aktivitetet dhe detyrimet e përcaktuara këtu.

5. Titullari i Projektit do të bashkëpunojë në mënyrë aktive me operatorin e projektit, të cilit do t'i jepet kontrata për vendosjen e një ndërtese modulare bazuar në procesin e prokurimit publik të kryer nga CMS-ja.

6. Njësia Zbatuese do të kryejë zbatimin e projektit bazuar mbi parametrat thelbësorë të përmendur më poshtë:

- llojin e ndërtimit modular;

- konfigurimi i menjëhershëm (zbatimi i shkurtër dhe cikli i ndërtimit);

- përdorim i shpejtë i objekteve arsimore (shkolla);

- rezistent ndaj tërmeteve dhe të sigurta;

- zbatimi i standardeve të edukimit dhe shëndetit të Bashkimit Evropian;

- në përputhje me standardet e cilësisë të Bashkimit Evropian.

7. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të monitorohet nga grupi i punës, siç përcaktohet në nenin 5.

8. Trualli i sheshit të ndërtimit do të dorëzohet në përputhje me tekstin e kësaj Marrëveshjeje. Të gjitha detyrimet e palëve të treta në sheshin e ndërtimit (shpronësimet) dhe të gjitha detyrimet ligjore i takojnë autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë duke përfshirë dhe titullarin e Projektit.

9. Trualli do të dorëzohet nga titullari i Projektit, e lirë nga çdo gjë, si pengjet apo mbajtja e garancisë. Problemet e ndarjes në zona dhe të pronësisë nëse ka, në lidhje me trojet, do të zgjidhen nga autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë duke përfshirë dhe Titullarin e Projektit dhe do të jete në harmoni dhe në përputhje me këtë Marrëveshjeje.

10. Titullari i projektit do të garantojë disponueshmërinë e sheshit të ndërtimit me të gjithë infrastrukturën e nevojshme të shërbimeve publike/komunale, si dhe disponimin e dokumentacionit të nevojshëm (lejet, licencat, autorizimet etj.) për titullarin e Projektit të zgjedhur nga Njësia Zbatuese, për zbatimin e këtij projekti.

11. Donacioni i ofruar sipas kësaj Marrëveshjeje do t'u nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore në fuqi për përjashtimet fiskale përkatëse, të parashikuara në kuadrin ligjor për procesin e rindërtimit (të gjitha taksat, tatimet, shumat, detyrimet doganore ose kostot e tjera të ngjashme janë të pazbatueshme). Në një rast kur ndonjë taksë, tatim, shumë, detyrim doganor ose kosto të tjera të ngjashme (në vijim të njohura si Taksat dhe Tatimet) është apo bëhet i zbatueshëm për këtë marrëveshjeje apo donacion sipas Marrëveshjes së Grantit, të nënshkruar ndërmjet njësisë zbatuese



dhe operatorit të projektit, çdo taksë apo detyrim i tillë do të mbarten nga Republika e Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, me anë të përdorimit të çdo përpjekjeje të arsyeshme, mundëson të sigurojë çdo përjashtim të mundshëm apo lehtësim prej saj, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të paguajë apo do të detyrojë të paguajë apo rimbursojë Njësine Zbatuese nëse Njësia Zbatuese ka paguar këto taksa dhe tatime dhe Këshilli i Ministrave do të dëmshpërblejë, mbrojë dhe do të mbajë të padëmtuar Njësine Zbatuese nga dhe në ngarkim të çdo pagese për këto tatime dhe taksa.

12. Dorëzimi i ndërtesës modulare do të kryhet ndërmjet Donatorit (Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Teknologjisë së Republikës së Sllovenisë) dhe titullarit të Projektit si autoriteti përgjegjës në favor të të cilit projekti po zbatohet. Titullari i Projektit do të sigurojë mirëmbajtje të rregullt të objektit gjatë kohëzgjatjes së tij.

13. Sipas kësaj Marrëveshjeje, Donatori (Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Teknologjisë së Republikës së Sllovenisë) do të përfitojë nga lehtësirat fiskale bazuar në ligjin nr. 97/2019, lidhur me miratimin e aktit normativ nr. 9, të datës 16. 12. 2019, të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, “Akti normativ për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, si dhe dispozitat në fuqi të legjislacionit fiskal të Republikës së Shqipërisë lidhur me procesin e rindërtimit.

Neni 4

Financimi i Projektit

Pasi të nënshkruhet kjo Marrëveshje bashkëpunimi, një Marrëveshje Granti do të nënshkruhet ndërmjet Njesisë Zbatuese dhe titullarit të Projektit për projektin e ngritjes së ndërtesës modulare për qëllime arsimore. Marrëveshja e Grantit, referuar në nenin 3 më lart, do të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e Njesisë Zbatuese dhe titullarit të Projektit dhe kushtet e dhurimit. Njësia Zbatuese do të mbartë të gjitha shpenzimet lidhur me prokurimin, dorëzimin dhe ngritjen e ndërtesës modulare për qëllime arsimore në përputhje me këtë Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Marrëveshjen e Grantit. Titullari i Projektit do të mbartë kostot që lidhen me përgatitjen e sheshit të ndërtimit, të gjitha punët përgatitore (themelet, sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza,

elektricitetin dhe ujin në sheshin e punimit), të gjitha lejet e zbatueshme (ndërtimore, mjedisore, ...) dhe punimet përfundimtare dekorative. Titullari i Projektit do të bashkëpunojë në mënyre aktive me operatoren e projektit të cilit do t'i jepet kontrata bazuar mbi procesin e prokurimit publik, të kryer nga Njësia Zbatuese.

Neni 5

Formimi i një grupi pune

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, një “Grup pune” do të formohet nga përfaqësuesit e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Sllovenisë. Grupi i punës do të jetë në kontakt për përfundimin e projektit brenda afatit të përcaktuar dhe do të eliminojë menjëherë problemet që mund të ndodhin.

2. Lidhur me këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, Palët, nëse nevojitet, mund të nënshkruajnë protokolle shtesë ku përfshihen specifikimet teknike dhe kontrata e ndërtimit.

Neni 6

Konfidencialiteti i informacionit

Palët do të përdorin informacionin, dokumentet dhe projektet, të cilat shkëmbyen ndërmjet njëritjetrit për zbatimin e projektit, vetëm për qëllimet e përcaktuara brenda kuadrit ligjor për të cilin ata kanë rënë dakord dhe nuk do i transferojnë ato te Palët e treta pa miratimin me shkrim të Palës tjetër.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet, të cilat mund të lindin në lidhje me interpretimin e kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, do të zgjidhen përmes konsultimeve dhe negociatave ndërmjet Palëve.

2. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të zbatohet me kushtin që detyrimet e Palëve lidhur me pronën intelektuale, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare dhe legjislacionit kombëtar, të mos shkelen.



Neni 8

Hyrja në fuqi, vlefshmëria dhe ndryshimi

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën, përmes kanaleve diplomatike, për plotësimin e procedurave ligjore kombëtare të kërkuara për hyrjen e saj në fuqi.

2. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të mbetet në fuqi për një periudhë prej dy vitesh. Secila Palë mund të njoftojë me shkrim Palën tjetër, nëpërmjet kanaleve diplomatike, tre muaj para, me synimin e përfundimit të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi.

3. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të ndryshohet në çdo kohë mbi pëlqimin e përbashkët të Palëve. Ndryshimet pas kësaj do të hyjnë në fuqi sipas procedurës së përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni.

Bërë më 30.12.2020, në dy kopje origjinale, në gjuhët angleze, sllovene dhe shqipe, ku të gjitha tekstet janë njëllorj autentike. Në rast ndryshimesh në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Në emër të:

KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS
SHQIPËRISË

Arben Ahmetaj

MINISTËR I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN

Në emër të:

QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË
SLLOVENISË

Peter Japelj

AMBASADOR I
REPUBLIKËS SË
SLLOVENISË NË
REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË

URDHËR**Nr. 44, datë 26.1.2021**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP
PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË
PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS
NDËRMJET MINISTRISË SË
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DHE SUBJEKTIT FITUES TË
PROCEDURËS SË KONKURRIMIT
PUBLIK**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 16, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 31.7.2013 “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike tokësore dhe ujore”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e kontratës tip që do të lidhet ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe subjektit fitues të procedurës së konkurrimit publik për ushtrimin e së drejtës së peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det pa përdorimin e mjeteve lundruese dhe për zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike tokësore dhe ujore, sipas modelit bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi

**KONTRATË TIP**

PËR TË DREJTËN E PESHKIMIT NË
UJËRAT E BRENDSHME, FORMAT E TJERA
TË PESHKIMIT NË DET, PA PËRDORIMIN
E MJETEVE LUNDRUESE DHE PËR
ZHVILLIMIN E AKUAKULTURËS NË
SIPËRFAQE PUBLIKE TOKËSORE DHE
UJORE

Kjo kontratë lidhet sot, në datën _____, midis palëve si më poshtë:

Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në vijim “MBZHR”, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, _____, me seli: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 2, Tiranë.

dhe

Personit fizik/ juridik _____ me administrator _____, me numër NIPTI: _____, me adresë: _____, mbajtës i kartës së identitetit (ID) me nr. _____.

Baza ligjore: kjo kontratë lidhet në përputhje legjislacionin në fuqi të peshkimit dhe akuakulturës në momentin e nënshkrimit të saj.

Palët kontraktuese ranë dakord të nënshkruajnë kontratën me përmbajtje si më poshtë vijon:

Neni 1**Objekti i kontratës**

1. Kjo kontratë ka për qëllim _____ *(të vendoset aktiviteti; ushtrimin e së drejtës për peshkim në ujërat e brendshme/ ushtrimin e së drejtës për peshkim në det pa përdorimin e mjeteve kundruese/ zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike ujore dhe tokësore)* nga ana e personit fizik/juridik _____, me administrator _____, në objektin ujor: _____ me sipërfaqe _____, në territorin e qarkut të _____, Bashkia _____, Njësia Administrative _____, fshati _____.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i njeh të drejtën _____ *(të vendoset forma e aktivitetit)*, personit fizik/ juridik _____, me administrator _____, brenda të gjithë kuadrit ligjor që rregullon këtë aktivitet, në zonën e përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni.

Neni 2**Të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese**

1. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nëpërmjet strukturave të saj, merr masa brenda kompetencave ligjore, për të siguruar respektimin e të drejtës së ushtrimit të aktivitetit, që i është dhënë subjektit të mësipërm, nëpërmjet kësaj kontrate.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural gëzon të drejtën ligjore të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e subjektit për:

a) fillimin e investimeve brenda afatit ligjor prej 6 muajsh;

b) realizimin e investimeve në vite, sipas treguesve të deklaruar nga ana e tij në dokumentin e nivelit të investimeve apo planbiznesin e paraqitur si kërkesë për ushtrim të aktivitetit të ripopullimit të peshkimit;

c) aktverifikimin e investimeve të dokumentuara dhe të plotësuar nga ana e investitorit dhe subjektit që ushtron aktivitetin. Raporti i organit kompetent të ngarkuar për inspektim;

d) depozitimin rregullisht të deklarimeve statistikore pranë strukturave lokale deri më 31 mars të vitit në vazhdim;

e) respektimin e legjislacionit të peshkimit dhe të akuakulturës;

f) respektimin e legjislacionit në objektin ujor ku do të zhvillohet aktiviteti, si dhe i procedurave të trajtimit të produktit deri në treg.

3. Personi fizik/ juridik _____, me administrator _____, gëzon të drejtën e ushtrimit të së drejtës për peshkim të specieve të familjes së _____ në objektin ujor: _____, me sipërfaqe _____ në territorin e qarkut të _____, Bashkia _____, Njësia Administrative _____, fshati _____.

4. Personi fizik/juridik _____ zbaton detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor në fushën e peshkimit dhe akuakulturës si më poshtë:

a) kontraktuesi nuk ka të drejtë të lidhë nënkontraktime me subjekte të tjerë;

b) kontraktuesi detyrohet të lejojë dhe të shoqërojë organin kompetent të ngarkuar për inspektim dhe vëzhguesit/monitorët e MBZHR-së, të ushtrojnë kontrole për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara nga kjo kontratë, si dhe të



kryejnë detyrat funksionale në bazë të legjislacionit në fuqi;

c) kontraktuesi detyrohet të zbatojë çdo dispozitë të re ligjore ose ndryshim të dispozitave ligjore ekzistuese në fushën e peshkimit dhe akuakulturës.

Neni 3

Pagesa dhe regjimi i saj

1. Personi fizik/ juridik _____, me administrator _____, do të kryejë pagesën për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit ose akuakulturës, në vlerën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për taksat kombëtare, për llogari të Drejtorisë Tatimore, Tiranë (numri i llogarisë pranë Inspektoratit të Peshkimit të qarkut _____, rrethi _____).

2. Pagesa e parë do të kryhet menjëherë, në momentin e nënshkrimit të kontratës sipas kushteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për taksat kombëtare.

3. Pagesat në vitet e tjera do të kryhen brenda tremujorit të parë të vitit në vazhdim.

Neni 4

Mosrespektimi i kushteve të kontratës

1. Mosrespektimi i kushteve të kësaj kontrate duhet të konstatohet me një akt të veçantë (procesverbal), të mbajtur midis palëve ose përfaqësuesve të tyre, sipas dispozitave ligjore përkatëse, i cili nënshkruhet në prani të tyre.

2. Për çdo konstatim të shkeljeve të dispozitave të kësaj kontrate, zbatohen dispozitat ligjore në fushën e peshkimit dhe akuakulturës me masën e gjobës dhe me heqjen e së drejtës ose prishjen e kontratës.

Neni 5

Pezullimi i kontratës si rezultat i forcës madhore

1. “Forcë madhore”, do të quhet çdo rrethanë që në mënyrë të arsyeshme dhe objektive është tej parashikimit dhe kontrollit të drejtpërdrejtë apo tërthorë të palës së cenuar duke i shkaktuar pamundësi të plotë apo të pjesshme palës së cenuar për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj

sipas kësaj kontrate (përveç kryerjes së pagesave për ushtrimin e aktivitetit).

2. Rastet e forcës madhore përfshijnë:

a) Veprimet e luftës, pushtim, terrorizmin, kryengritjet, grevat në vendin e punës, grevat e përgjithshme apo lokale;

b) Rrufeja, zjarri, tërmeti, fatkeqësi të tjera natyrore;

c) Çdo akt sabotimi, drejtim i keq, krim i organizuar dhe/ose aktivitete pune që imponojnë apo pengojnë zbatimin e saj.

3. Pala e cenuar përjashtohet nga përmbushja e detyrimit për aq kohë dhe në atë masë sa zgjat pamundësia objektive për të përmbushur detyrimet.

4. Palët nuk humbasin të drejtën e zbatimit të kësaj kontrate. Për këto arsye detyrimisht përpilohet anekskontrata shtesë në të cilën do të përcaktohen edhe afatet e reja kohore të zbatimit të kontratës.

5. Dokumentimi i rastit të forcës madhore pasqyrohet në procesverbal të miratuar për çdo rast dhe në prezencë të organit të ngarkuar nga ligji për inspektimin.

Neni 6

Komunikimi

1. Çdo komunikim midis palëve për problemet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj kontrate do të bëhet me shkrim në këto adresa:

a) Personi fizik/juridik: _____.

Adresa: _____.

Adresa e-mail/tel/fax: _____.

Administratori ose përfaqësuesi: _____.

b) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Adresa: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.

2, Tiranë

Tel/fax: 35522667545

Web:www.Bujqesia.gov.al

2. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.



Neni 7

Modifikimi i kontratës

1. Si rregull i përgjithshëm, modifikime në këtë kontratë nuk lejohen.

2. Në raste të veçanta, kur janë verifikuar implikime të rënda në mjedis apo në rastet e shfaqjes së sëmundjeve që rezultojnë nga përdorimi i pajisjeve të përdorura, të përcaktuara në kontratë, çdo modifikim lejohet vetëm pas miratimit me shkrim nga të dy palët dhe përpilimit të Aneks – Kontratës përkatëse shtesë.

Neni 8

Kohëzgjatja e kontratës

1. Kjo kontratë lidhet për një periudhë _____ dhe sjell efekte nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

2. Me përfundimin e këtij afati, kontrata konsiderohet e zgjidhur.

Neni 9

Rastet e përfundimit të kontratës

1. Në rast se, nga struktura të tjera shtetërore merren vendime me rëndësi strategjike, të cilat bien ndesh me aktivitetin në sipërfaqet objekt kontrate, kontrata e peshkimit/akuakulturës revokohet, pa asnjë detyrim për palët kontraktuese.

2. Me pushimin së ekzistuari/mbarimin e personit fizik/juridik të cilit i është dhënë e drejta e ushtrimit të aktivitetit të peshkimit ose akuakulturës, në objektin ujqor përkatës.

Neni 10

Rinovimi i kontratës

Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë rinovimin e kësaj kontrate deri në 3 muaj përpara përfundimit të afatit të kontratës, vetëm nëse ka përmbushur kushtet ligjore të peshkimit dhe akuakulturës.

Neni 11

Zgjidhja e kontratës

1. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kontratës kur kontraktuesi nuk ka shlyer vlerën e taksës së zhvillimit të aktivitetit të përcaktuar në

nenin 4, të kësaj kontrate, brenda afateve të përcaktuara.

2. Kontraktuesit i shfuqizohet e drejta e ushtrimit të aktivitetit, me vendim të MBZHR-së, në rastet kur:

a) nuk e ka ushtruar të drejtën e peshkimit ose akuakulturës, pa shkaqe të arsyeshme, për një periudhë kohore mbi 6 muaj;

b) ka cenuar rëndë mjedisin;

c) nuk ka respektuar zonën e caktuar për zhvillimin e aktivitetit të përcaktuar në këtë kontratë;

d) nuk realizon brenda një viti nga çasti i nënshkrimit të kësaj kontrate, vlerën e investimit të parashikuar për vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit sipas dokumenteve (planbiznesit) të paraqitura për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit ose akuakulturës;

e) nëse pas nënshkrimit të kontratës, vërtetohet me fakte, se e drejta e zhvillimit të aktivitetit është dhënë në bazë të të dhënave jo të sakta dhe fakteve të pavërteta;

f) me vullnet të lirë kërkon prishjen e kontratës.

Neni 12

Mosmarrëveshjet

1. Kjo Kontratë do të interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar. Çdo mosmarrëveshje e lindur në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate, zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve, duke arritur në një marrëveshje të pranueshme pa cenuar vlerat, afatet, kushtet teknike, sanksionet dhe gjokat.

2. Në të kundërt palët mund t'i drejtohen Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, në territorin brenda të cilit shtrihet objekti ujqor për të cilin subjekti ka fituar këtë të drejtë, vendimi i së cilës është i ankimeshëm në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 49/2012 “Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga palët kontraktuese.



Neni 14

Gjuha dhe numri i kontratave

Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet nga palët pjesëmarrëse në 4 (katër) kopje të barasvlershme, nga të cilat një kopje e mban kontraktuesi.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Personi fizik/juridik

Sekretari i Përgjithshëm**Administratori****VENDIM****Nr. 1681/15, datë 29.1.2021****PËR REZULTATIN E ZGJEDHJEVE
DHE SHPALLJEN E FITUESVE**

Në mbështetje të nenit 115, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni i Votimit, me përbërje:

Adnan Xholi, kryetar;

Anila Leka, anëtar;

Alfred Progonati, anëtar,

pasi u administrua gjithë dokumentacioni i votimit, numëroi votat, përpiloi procesverbalin përkatës,

VËREN:

Në përfundim të procesit të votimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve për zgjedhjen e dy anëtarëve prokurorë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, kandidatët sipas numrit më të madh të votave të vlefshme, renditen në mënyrën si vijon:

Për anëtar prokuror nga radhët e prokurorive të shkallëve të para:

Elaida Goxhi 104 vota,

Zeqir Hoha 91vota,

Albert Kuliçi 45 vota,

Elona Alvora 9 vota.

Për anëtar prokuror nga radhët e prokurorive të apeleve:

Moisi Duda 238 vota.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenin 115, paragrafët 5 e 7, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe nenit 15 të rregullores së Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve, Komisioni,

Faqe | 2276

VENDOSI:

1. Të shpallë fitues si përfaqësues të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë:

Elaida Goxhi

2. Të shpallë fitues si përfaqësues së prokurorive të apelit:

Moisi Duda

3. Ky vendim të shpallet zyrtarisht në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme jo më vonë se 24 orë nga mbyllja e Mbledhjes së Përgjithshme.

4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më datë 28.1.2021, ora 15:20.

KOMISIONI I VOTIMIT**Kryetar, Adnan Xholi****Anëtarë, Anila Leka, Alfred Progonati****KËRKESË****Nr. 1263, datë 29.1.2021****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit: “Rikualifikimi urban i bllokut nr. 1, lagja nr. 2”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Bashkia Cërrik.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pasuritë e llojit “ndërtesë”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

- Vlera totale e shpronësimit është 545,580 (pesëqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR**I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË****Etjen Xhafaj**



**TABELA PARAPRAKE ME LISTËN E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, DHE VLERAT E SHPRONËSIMIT, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT:
“RIKUALIFIKIMI URBAN I BLOKUT NR. 1 , LAGJA NR. 2”, BASHKIA ÇËRRIK**

Nr.	Emër, Mbiemër	Zona kadastrale	N./pasurisë	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Vlera e objektit të shërbimit sipas situacionit (lekë)	Vlera totale (lekë)	Konfirmimi nga ASHK Elbasan
1	Nail Hazbi Shabani	1389	4/87/2	Ndërtesë	m ²	36	392,530	392,530	Konfirmuar nga ASHK Elbasan, urdhër kufizimi.
2	Nazmi Ramis Kerkapi	1389	4/112-ND	Ndërtesë	m ²	18	153,050	153,050	Konfirmuar nga ASHK Elbasan, urdhër kufizimi.
VLERA PARAPRAKE E SHPRONËSIMIT NË TOTAL						54		545,580	

**KËRKESË****Nr. 1148/2, datë 28.1.2021****PËR SHPRONËSIM ME INTERES
PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të llojit “tokë truall”, që preken nga ndërtimi i objektit: “Itinerare këmbësorësh me pistë vrapimi dhe biçikletash në Parkun e Liqenit Artificial”. Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private (sipas tabelës bashkëlidhur), të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur në bazë të VKM-së nr. 89, datë 3.6.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”. Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, si dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në

këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit dhe marrjes në përdorim të përkohshëm. Lutemi pronarëve dhe personave që pretendojnë pronësinë mbi pasuritë që preken nga ky projekt të dorëzojnë çdo dokument që disponojnë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, mbi saktësimin dhe konfirmimin e pronësisë, sipërfaqeve, mungesat e dokumentacionit etj.

Vlera totale e shpronësimit është 124,169,229 (njëqind e njëzet e katër milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e njëzet e nëntë) lekë.

**ZËVENDËSMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Etjen Xhafaj**



TABELA PARAPRAKE “ITINERARE KËMBËSORESH ME PISTË
VRAPIMI DHE BIÇIKLETASH NË PARKUN E LIQENTËT ARTIFICIAL”

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale truall (m ²)	Sip. truall i prekur (m ²)	Çmimi i truallit lek/m ²	Sip. obj. të prekura (m ²)	Çmimi obj. lek/m ²	Vlera në lekë	Shënime në kartelë	Konfirmimi
1	B.P. Peti, Pasholli; Guraja	Truall	8280	1/461	3,750.00	158.00	29543	0.00		4,667,794	C- T. pj. pasurie	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
2	B.P. Caushi, Kuci, Bakalli	Truall	8280	1/463	3,750.00	304.00	29543	0.00		8,981,072	C- D. trashëgimie	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresat nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020 dhe nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
3	B.P. Brahja, Dorda, Blushi, Opingari, Mija, Saliko, Brahja dhe Peti	Truall	8280	1/394	3,934.60	24.00	29543	0.00		709,032	C- D. trashëgimie nr. 752/427/3, datë 22.5.2018, not. S. Shatku	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresat nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020 dhe nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020
4	Shtet	Shesh	8280	1/399	59,294.60	238.00	0	0.00	0.00	0	C- Ndarje pasurie	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
5	Shtet	Rrugë	8280	1/301	321.00	46.00	0	0.00	0.00	0		Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
6	B.P. Brahja dhe Muhaxhiri	Truall	8280	1/419	239.00	11.00	29543	0.00		324,973	T. pj. pasurie	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
7	Edmond Brahja	Truall	8280	1/418	468.60	128.00	29543	0.00		3,781,504	Rivlerësuar për shumën 14234193 lekë, datë 29.5.2013; C- Kontratë shitje 226/81, datë 13.6.2013, not E. Qylafku	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.06.2020
8	Alush Brahja	Truall	8280	1/416	468.60	129.00	29543	0.00		3,811,047	C- T. pj. pasurie	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
9	Maliq Brahja	Truall	8280	1/415	468.60	82.00	29543	0.00		2,422,526	C- T. pj. pasurie	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
10	B.P. Brahja dhe Xibri	Truall	8280	1/73	3,750.00	328.00	29543	0.00		9,690,104	C- Dëshmi trashëgimie	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.



11	Vath Mehmet Brari	Truall	8280	1/79	760.00	30.00	29543	0.00	886,290	C- K. pjesëtim; D- Sipas shkresës nr. 243, datë 26.4.2011 bëhet regjistrimi i inventarizimit për pasuritë trashëgimore në emër të debitorëve; E- Deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i rregullt në sistemin hipotekor. Shkresë përmbartimi ku kuf. pasuria në bazë të vendimit të gjykatës nr. 8370, datë 3.11.2015 ardhur nga “Adrogrup”	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020
12	Rukije Xibri	Truall	8280	1/388	728.70	74.00	29543	0.00	2,186,182	Rivlerësuar për 87456000 lekë, mandat 26.3.2012; C- V. Gj.; Pj. pas.	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresat nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020 dhe nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
13	Dylbere Xibri	Truall	8280	1/389	728.80	72.00	29543	0.00	2,127,096	Rivlerësuar për 87456000 lekë, mandat 26.3.2012; C- V. Gj.; Pj. pas.	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresat nr. prot. 10470/2, datë 29.06.2020 dhe nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
14	B.P. Dardha, Duraku dhe Xibri	Truall	8280	1/390	729.00	71.00	29543	0.00	2,097,553	C- D Trashëgimie nr. 2725/1184, datë 5.12.2017, not. S. Malaj	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.06.2020.
15	Selman Xibri	Truall	8280	1/391	728.60	91.00	29543	0.00	2,688,413	Rivlerësim për shumën 87456000 lekë, mandat 26.3.2012; C- Pj. pas.; V. gjy.	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresat nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020 dhe nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
16	Kujtim Xibri	Truall	8280	1/392	728.70	134.00	29543	0.00	3,958,762	Rivlerësohet për shumën 87.444.000 lekë, mandat datë 8.8.2012; C - V. gjykate nr. 2056, datë 29.4.2004	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
17	Rexhep Brahja	Truall	8280	1/421	346.60	105.00	29543	0.00	3,102,015	C- T. pj. pasurie	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
18	Shyqri Reshit Brahja	Truall	8280	1/417	468.60	123.00	29543	0.00	3,633,789	C- T. pj. pasurie	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
19	Elona Sefer Baçe	Truall	8280	1/103	1,386.00	81.00	29543	0.00	2,392,983	Pasuria është në proces gjyqësor në Gjykatën e Lartë; C- K. shkëmbimi nr. 1677/653, datë 11.11.2016; E- pasuria është në proces gjyqësor në Gj. L. nr. regj. 719, datë 17.2.2016, nr. 1261 regj., datë 10.3.2016	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
20	B.P. Peti	Truall	8280	1/102	5,500.00	125.00	29543	0.00	3,692,875	C- VKKP	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.



21	Shtet	Truall	8280	1/408	321.00	115.00	0	0.00		0	Vijon nga vol. 1188	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
22	B.P. Gjini	Truall	8280	1/405	2,945.00	19.00	29543	0.00		561,317	C- Pjesëtim pasurie	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
23	Shtet	Shesh	8280	1/425	2,405.95	403.00	0	0.00	0.00	0	Park; C- T. nd. pasurie	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
24	Shtet	Shesh	8280	1/441	114,444.00	3068.00	0	0.00	0.00	0	C- Nd. pas.	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
25	Bashkia Tiranë	Liqen	8280	1/3	333,473.00	231.00	0	0.00	0.00	0	C- VKM-ja nr. 281, datë 9.5.2007	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
26	Ymer Brari	Truall	8280	1/378	382.00	31.00	29543	0.00		915,833	C- K. Pjesëtimi; E- deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekor	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
27	Ymer Brari	Truall	8280	1/379	322.00	50.00	29543	0.00		1,477,150	C- K. Pjesëtimi; E- deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekor	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
28	Majlinda Atuf Kotorri	Truall	8280	1/376	765.00	13.00	29543	0.00		384,059	C- Kontratë dhurimi nr. 3807/1792, datë 18.11.2016	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
29	B.P. Alla, Simoni	Truall	8280	1/375	3,570.00	223.00	29543	0.00		6,588,089	C- Dëshmi trashëgimie 9447 akti, nr. 2490 vendim, datë 16.3.2012	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
30	B.P. Alla	Truall	8280	1/377	765.00	25.00	29543	0.00		738,575	C- Urdhër korrigjim emri	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
31	B.P. Peti	Truall	8280	1/435	2,918.00	171.00	29543	0.00		5,051,853	C- T. nd. pasurie	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresat nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020 dhe nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
32	Shtet	Truall	8280	1/436	476.00	19.00	0	0.00	0.00	0	C- T. nd. pasurie; E- kjo pasuri është e okupuar	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
33	Shtet	Truall	8280	1/334	517.00	3.00	0	0.00	0.00	0	E- Kjo pasuri është e okupuar nga z. Fatmir Sadik Tahiraj	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
34	B.P. Xhabrahimi, Peti, Sina	Shesh	8280	1/442	5,600.00	111.00	29543	0.00		3,279,273	C- D. trash. 471/290, datë 28.2.2015, not. E.S.; E- Në bazë të shkresës së Z. Përmbartimit Tiranë nr. 3469 prot., datë 21.5.2004, vihet sekuestro për debit. Mehmet Peti	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
35	Shtet	Rrugë	8280	1/348	392.00	20.00	0	0.00	0.00	0		Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.



36	B.P. Brari, Stafa	Truall	8280	1/48	1,450.00	73.00	29543	0.00		2,156,639	C- Urdhër; E- deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekor	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
37	B.P. Brari, Kasa, Brrai	Truall	8280	1/47	1,600.00	10.00	29543	0.00		295,430	C- DTSH 3649, datë 22.4.2008, DTSH 193, datë 21.1.2013; E- deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekor	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
38	Hamid Hajdar Brari	Truall	8280	1/60	825.00	32.00	29543	0.00		945,376	C- Kontratë pjesëtimi; E- Deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekor	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
39	Ymer Brari	Truall	8280	1/50	1,500.00	69.00	29543	0.00		2,038,467	C- K. Pjesëtimi; E- Deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekor	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
40	Shtet	Truall	8280	1/32	4,491.00	1.00	0.00	0.00	0.00	0	Refuzon matjet; C- LN 2010; E- Pasuri e okupuar	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
41	Shtet	Shesh	8280	1/427	33,345.00	1780.00	0.00	0.00	0.00	0	Park; C- T. nd. pasurie	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
42	Caje – Hoxha	Truall	8280	1/71	3,000.00	119.00	29543	0.00		3,515,617	C- K. shkëmbimi 758/560, datë 15.4.2013, not. Gj. Kongoli	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
43	Shaban Brari	Truall	8280	1/78	900.00	40.00	29543	0.00		1,181,720	C- K. pjesëtimi; D- Sipas shkresës nr. 243, datë 26.4.2011, bëhet regjistrimi i inventarizimit për pasuritë e trashëgimtarëve në emër të debitorëve; Regjistrohet kërkesë padia me v. gjyq.; E- Deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekor; Pronari ka një ndërtim pa leje	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
44	Shtet	Rrugë	8280	1/366	6,846.00	142.00	0	0.00	0.00	0		Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
45	Shtet	Shesh	8280	1/443	4,441.00	466.00	0	0.00	0.00	0	C- T. nd. pasurie	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
46	Shtet	Rrugë	8280	1/355	1,157.00	33.00	0	0.00	0.00	0		Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
47	B.P. Peti; Xhabrahimi; Sina	Shesh	8280	1/438	400.00	20.00	29543	0.00		590,860	C- TR 471/290, datë 28.2.2015, not. E.S.; E- Në bazë të zyrës së përbarimit nr. 3469, datë 21.5.2004, vihet në sekuestro për debit prona e Mehmet Petit	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.



48	Shtet	Shesh	8280	1/371	61,457.00	4813.00	0	0.00	0.00	0		Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
49	Gazmend Ramazan Shkodra	Truall	8280	1/406	700.00	67.00	29543	0.00		1,979,381	C- Pjesëtim pasurie	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
50	B.P. Llapashtica dhe Gjika	Truall	8280	2/98	4,000.00	144.00	29543	0.00		4,254,192	K. shitjeje	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
51	Shtet	Rrugë	8280	1/10	5,857.00	3856.00	0	0.00	0.00	0		Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
52	B.P. Peti, Hoxha, Shkreta, Krasniqi (Peti), Shera (Peti)	Truall	8280	1/467	6,400.00	529.00	29543	0.00		15,628,247	C- D. trash test 1791/1148, datë 5.6.2018, not. A. Skendaj	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
53	B.P. Tresa, Hidri, Demneri, Llulla, Cufi (Dyli), Oruci, Gega, Kumi	Truall	8280	1/450	2,026.00	387.00	29543	0.00		11,433,141	C- D. tr. 1286/423, datë 20.2.2019, not. M. Shehu; E- Vendoset sekuestro konservative mbi pasurinë me shkresën nr. 28900, datë 28.7.2017, të ZVRPP-së Tiranë për pjesën takuese të Albano Xhavit Tresa	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresat nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020 dhe nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
54	Shtet	Shesh	8280	2/31	160,968.00	29.00	0	0	0	0		Konfirmim nga ASHK-ja me shkresat nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020 dhe nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
55	Shtet	Truall	8280	2/383	166,757.20	2818.00	0	0	0	0	C- T. nd. pasurie; D- Mbi këtë truall është regjistruar, në bazë të l. leg., ndërtesa me nr. pas. 2/78/nd., vol. 3, f. 17, z.k. 8280; E- Kjo pasuri është e okupuar	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
Total						19437				124,169,229		

1. Për tokën truall, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.

2. Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj liste, janë bazuar në shkresën e ASHK-së, Tiranë, nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020 dhe nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë